Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 MASHTI në vitin 2024 (duke u bazuar në planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 3,734,357€ në kategori ekonomike jo adekuate.

B2 Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 3,898,234€ pasi që në regjistrin e tyre ishin të përfshira edhe gjashtë raste kur detyrimi ligjor për Ministrinë kishte përfunduar.

B3 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte nënvlerësuar për 1,232,643€, si rezultat i mos regjistrimit të blerjeve të vitit për shkollat.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Në kuadër të MASHTI-it, janë 22 pozita që mbulohen me ushtrues detyre/zëvendësues për një periudhë më të gjatë se periudha e lejuar me ligj.

A2 Në pesë (5) raste në vlerë 75,264€ kishte vonesa në liferimin e mallrave përtej afatit të përcaktuar në kontratë, vonesat ishin nga pesë (5) deri në 129 ditë.

A3 Subvencionimi për blerjen e librave për klasat 1-9 ishte përcjellë me dobësi, ku si pasojë rastet kur përfituesit nuk kualifikoheshin për subvencionim arrin vlerën 60,780€.

A4 Tetë (8) pagesa në vlerë totale prej 213,483€ kishte vonesa në pagesa nga tetë (8) deri 116 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2024 ka shpenzuar 81% të buxhetit final, duke shënuar një zvogëlim prej 6% krahasuar me vitin 2023. Çështjet e identifikuara që kanë ndikuar te opinion i pasqyrave financiare janë, klasifikimi jo adekuat të shpenzimeve, mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente dhe nënvlerësimi i pasurive kapitale.

Te konkluzioni i pajtueshmërisë kanë ndikuar çështjet si: vonesa në liferimin e mallrave, financimi i librave shkollor për klasat 1-9 dhe vonesat në pagesën e faturave.

Ndërsa çështjet tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë janë, mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, mangësi në procesin e vlerësimit të tenderëve, menaxhimin e proceseve të prokurimit, mbajtje të avanceve të hapura për projekte kapitale, menaxhimi i kontratave jo përmes e-prokurimit, mungesa e njoftimit paraprak, vonesa në realizimin e projekteve kapitale, shkëputja e kontratave për projektet kapitale, mungesa e dëshmive për pagesat e vendimeve gjyqësore, menaxhimi i pasurive jo financiare procedimin e pagesave si dhe mos funksionimi i komitetit të auditimit.

Po ashtu, ne si ekip kemi dhënë këshilla për përmirësimin e draft pasqyrave financiare vjetore të MASHTI për vitin 2024, të cilat pas rekomandimeve tona, janë përmirësuar.

Raporti ka rezultuar me gjithsej 15 rekomandime, prej të cilave 10 rekomandime janë të reja dhe 5 (pesë) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 e Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike kërkon që shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për Planin Kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të siguroj që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në vitin 2024, MASHTI ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 3,734,357€ në kategori ekonomike jo adekuate.

Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin realizuar 18 pagesa në vlerë 2,367,808€ që për nga vlera individuale e pajisjeve dhe natyra e tyre këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si në vijim:

- Furnizim me pajisje për shkollat e arsimit parauniversitar, pako laboratorike, inventar për çerdhe, pajise të sanitarisë në vlerë

2,268,075€;
- Furnizim me kompjuter dhe mobile në Universitetin e Gjakovës në vlerë 1,730€;
- Furnizim me pajisje të TI-së në Universitetin e Mitrovicës 89,460€; si dhe;
- Furnizim me mobile për zyre nga Universiteti i Gjilanit në vlerë 8,543€.

Ndërsa, pagesa të realizuara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve që duhej të klasifikoheshin si investime kapitale dhe paga e mëditje, ishin 12 pagesa në vlerë 1,366,549€:

- Nëntë (9) pagesa në vlerë 1,145,416€ të cilat i takonin kategorisë së investimeve kapitale të cilat kryesisht kishin të bënin me hartim dhe mbikëqyrjen e projekteve si dhe zhvillim modulesh softuerike; si dhe
- Tri (3) pagesa në vlerë 221,133€ të cilat ishin realizuar sipas nenit 40 të LMFPP, i takonin kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, pavarësisht kërkesës së MASHTI-t që mjetet për këto projekte të buxhetohen në kategoritë adekuate. Po ashtu, edhe keqklasifikimi nga mallra dhe shërbime ishte rezultat i buxhetimit jo të drejtë, por edhe tërheqjes së mjeteve nga ana e thesarit si rezultat i përmbarimeve dhe vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve, duke ofruar kështu informata jo të sakta. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mbivlëresimi i Detyrimeve Kontigjente

Gjetja

Neni 6 i Rregullores 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton se " Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Gjatë testimeve tona, kemi evidentuar pasaktësi në raportimin e detyrimeve kontigjente në vlerë 3,898,234€:

- Një (1) rast në vlerë 3,586,000€, pala paditëse ishte tërhequr nga padia;
- Katër (4) raste në vlerë 267,504€, ishin paguar gjatë vitit; si dhe
- Një (1) detyrim në vend që të shpalosej në vlerë 4,970€ ishte shpalosur si 49,700€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe zyrës së financave në kuadër të MASHTI-it si dhe dobësive në kontrolle lidhur me mbajtjen e evidencave të plota dhe raportimit të saktë të tyre në PFV.

Ndikimi Shpalosja jo e plotë dhe e saktë e detyrimeve kontigjente ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë, duke pasur ndikim negativ në vendimmarrje.

Rekomandimi B2 Ministri, duhet të siguroj një koordinim dhe komunikim të duhur në mes zyreve ligjore të të gjitha njësive vartëse dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Nënvlerësimi i pasurive kapitale

Gjetja Sipas nenit 16 të rregullores MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, zyrtari i pasurisë jo financiare do të jetë përgjegjës për evidentimin përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përgjithshëm të pasurive me të gjitha informatat që kërkohen në dispozitat e kësaj rregullore dhe ligjeve të tjera në fuqi. Zyrtari i pasurisë jo financiare do t'i regjistrojë në mënyrën e duhur të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se pasuria është në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore.

Gjatë auditimit të PFV për vitin 2024, kemi konstatuar që MASHTI kishte nënvlerësuar pasuritë në vlerë 1,232,643€, për shkak të mos regjistrimit të pasurisë në regjistrat e saj, për çështjet në vijim:

- Pajisjet e gatshme për mirëmbajtje për fushat lëndore të blera për shkollat e ulëta dhe të mesme të komunave të ndryshme të Kosovës në vlerë 448,057€;
- Furnizimi me pako laboratorike për shkollat e ndryshme në vlerë 537,652€; si dhe
- Furnizimin me pajise të sanitarisë në shkollat fillore dhe të mesme në vlerë 246,934€.

Për këto pasuri, MASHTI nuk i kishte siguruar marrëveshjet e nënshkruara nga komunat përkatëse për bartjen e pronësisë së tyre dhe për këtë Ministria duhet t'i regjistronte ato si pjesë e pasurive të saj deri në momentin e marrëveshjeve për dorëzim/bartje të tyre.

Kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak dhe menaxhmenti i Ministrisë nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për ta adresuar edhe përkundër zotimit në planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive nga ana e MASHTI-it për pasuritë të cilat janë

shpërndarë nëpër shkolla dhe mos sigurimi i marrëveshjeve për bartjen e tyre në regjistrat e shkollave (në Komunat përkatëse) që kanë kontrollin dhe pronësinë si dhe mos regjistrimi i pasurive kanë ndikuar që vlera e tyre të mos jetë e saktë duke e nënvlerësuar pasurinë e Ministrisë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete që të gjitha pasuritë të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të regjistrohet ose të barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e Komunave. Po ashtu, pasuritë e gatshme (pajisjet e ndryshme) që blihen për shkolla përkatëse të regjistrohen direkt në regjistrat e shkollave-komunave pas sigurimit të marrëveshjeve të nënshkruara nga të dyja palët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 35 Ushtruesja/i e/i detyrës, paragrafi 3 Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.

Në kuadër të MASHTI-it, janë 22 pozita që mbulohen me ushtrues detyre/zëvendësues për një periudhë më të gjatë se periudha e lejuar me ligj. Këto janë si në vijim:

- Pozita e Udhëheqëses së Divizionit për Inovacion dhe Udhëheqëses së Divizionit për Koordinim të Politikave, mbulohet me ud/zëvendësues që nga viti 2018, duke tejkaluar afatin ligjor;
- 19 pozita në administratën e MASHTI-it mbulohen me ud/zëvendësues duke i tejkaluar afatet e lejuara ligjore nga 2 muaj deri në 5 vite;
- Tri (3) pozita të tjera në Inspektoratin e Arsimit, Universiteti Haxhi Zeka dhe Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional duke i tejkaluar afatet e lejuara nga 1 muaj deri në 6 vite.

Sipas zyrtarëve të MASHTI-it kjo kishte ndodhur për faktin se rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës kishte hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2024.

Ndikimi

Mbulimi i pozitave të rëndësishme me ushtrues detyre për një kohë të gjatë se periudha e lejuar, krijon pasiguri në vendimmarrje dhe përgjegjësitë e funksioneve kyçe. Njëherit, është në kundërshtim me kërkesat ligjore si dhe ndikon negativisht në efektivitetin e administratës dhe institucioneve vartëse.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë që brenda një afati të arsyeshëm të zhvillojë procedurat e rekrutimit në përputhje me kërkesat ligjore për plotësimin e pozitave që mbahen me ushtrues detyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Vonesa në liferimin e mallrave

Gjetja

Sipas nenit 2 të kontratës, por edhe kushteve të veçanta të kontratës, definon qartë afatin e liferimit të mallit, i përcaktuar në ditë.

Gjatë testimit të pagesave, ne kemi vërejtur që në pesë (5) pagesa në vlerë të përbashkët 75,264€ kishte vonesa në liferimin e mallrave përtej afatit të përcaktuar në kontratë, të cilat variojnë nga 38 deri në 129 ditë vonesë. Këto vonesa janë vërejtur te kontrata "Furnizim me lëndë të parë dhe pajisje të profilit të floktarisë, estetikës për kryerjen e praktikës profesionale"

dhe kontrata "Furnizim me material të teknikës dhe axhustator".

Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizime dhe dukuria e mos respektimit të rregullave për procesim të urdhër blerjeve në kohën e duhur.

Ndikimi

Vonesat e gjata të liferimit të mallrave duke mos i respektuar afatet e përcaktuara me kontratë si dhe mos respektimi i rregullave për procesimin e urdhër blerjeve me kohë ndikon në mos realizimin e aktiviteteve apo projekteve të ministrisë si dhe pamundëson aplikimin e penaleve për ditët e vonesave.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale dhe në rastet e pajustifikuara të vonesave në liferim të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Financimi i Librave Shkollor për klasat 1-9

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 04/L-032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës Neni 5 Detyrat e Ministrisë, paragrafi 13 thekson që Ministria nxjerr akt nënligjor për shpërndarjen e teksteve shkollore falas dhe ruajtjen e tyre, sipas dispozitave të nenit 26 dhe 27 të këtij ligji. Me vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishin ndarë mjete në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për blerjen e teksteve dhe materialeve mësimore, administrimi i të cilit proces ishte realizuar përmes platformës e-Kosova.

Duke pas parasysh që shuma e subvencionimit për blerjet e teksteve dhe materialeve mësimore për këtë vit arrijnë vlerën 20,417,460€ dhe për të siguruar që mjetet e ndara janë transferuar tek përfituesi i duhur, ne analizuam diferencat më të mëdha, duke krahasuar numrin e nxënësve në softuerin e MASHTI-it SMIA dhe aplikimet në e-Kosova, në nivelet komunale, respektivisht shkollat me diferencë më të madhe.

Nga 22 shkollat e përzgjedhura në pesë (5) komuna të Kosovës nga 878 shkolla dhe paralele të ndara të nivelit 1-9 të regjistruara në SMIA dhe pas konfirmimeve nga Drejtoritë Komunale të Arsimit të Komunave respektive, ne hasem në raste kur përfituesit nuk kualifikoheshin për subvencionin në fjalë. Shuma totale e këtyre rasteve arrin vlerën 60,780€.

- 308 përfitues parafillor në vlerë totale 24,640€;
- 183 përfitues të shkollimit të mesëm në vlerë totale 20,130€;
- 154 përfitues që ishin jashtë shteti në vlerë totale 14,150€; dhe
- 18 raste ishin braktisje shkollimi në vlerë 1,860€;

Gjatë konfirmimeve ne hasem po ashtu edhe 942 raste në vlerë 78,090€ të cilat ishin të pa identifikueshëm për shkollat nga e cila është bërë aplikimi. Sa për sqarim, këto raste ekziston mundësia që të kualifikohen individ që gabimisht kanë përzgjedhur shkollën gjatë aplikimi ose të atillë që ju takojnë katër kategorive të mësipërme.

Kjo ishte si rezultat që me rastin e kalimit në formën e re të financimit nuk

janë paraparë kufizime për personat që nuk kualifikohen për përfitim dhe platforma e-Kosova ua ka mundësuar aplikimin e një gjëje të tillë, përderisa shuma e shpalosur si borxh në PVF për nxënësit që ende nuk i kanë marrë mjetet arrijnë vlerën 44,920€.

Po ashtu, sipas zyrtarëve të MASHTI-it kjo ka reflektuar edhe si rezultat i bashkëpunimit jo të mirë nga komunat për verifikimet e përfituesve.

Ndikimi Mos aplikimi i kritereve kufizuese në platformë si dhe mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimit gjatë shpërndarjes së subvencioneve për libra, ka ndikuar që të përfitojnë subvencion përfituesit të cilët nuk kualifikoheshin për këtë qëllim. Njëherit, kjo mund të ndikojë që përfituesit që kualifikohen të mbesin pa subvencion.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të forcojë kontrollet dhe mekanizmat e mbikëqyrjes për të siguruar që shpërndarja e fondeve publike të bëhet në përputhje me kriteret dhe vendimin e qeverisë, duke siguruar që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për tua pamundësuar përfitimin individëve të cilët nuk kualifikohen për këtë qëllim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i LMFPP, përcakton që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë auditimit kemi hasur në tetë (8) pagesa në vlerë totale prej 213,483€ në të cilat kishte vonesa në pagesa nga tetë (8) deri 116 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Shkaqet për vonesa ishin për shkak të kontrolleve joadekuate në ekzekutimin e pagesave si mos përcjellja me kohë e faturave në zyrë të financave.

Ndikimi Vonesat në pagesa ndaj furnitorëve rrit rrezikun që në periudhat e ardhshme Ministria të ballafaqohet me padi gjyqësore/përmbarimore të cilat mund të rezultojnë me shpenzime shtesë duke e renduar buxhetin e Ministrisë.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv në të cilin të gjitha faturat procedohen me kohë për pagesë në mënyrë që të eliminohen vonesat e paarsyeshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 26,412,567€, prej tyre ishin shpenzuar 16,606,490€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtimin e objekteve arsimore, paisjeve të teknologjisë informative, softuer, blerje të inventarit dhe pajisjeve laboratorike, si dhe pajisje për salla sportive.

Çështja A5 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja	Sipas paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullorës 001/2022 për Prokurimin Publik, funksionet e menaxherit të kontratës kërkojnë që për secilën kontratë "Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Procesi i menaxhimit të kontratave nuk ishte plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore pasi që kontratat e ekzaminuara nuk menaxhoheshin përmes platformës elektronike. Bazuar në mostrat e audituara ne identifikuam që për këtë pjesë menaxherët e kontratave nuk kishin vendosur ndonjë informatë në modulin e-prokurimi edhe pse vazhdonin të ishin menaxher të kontratës. Moduli e-prokurimi nuk ishte aplikuar për asnjërën nga kontratat dhe nga asnjëra njësi vartëse. Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me përdorimin e modulit e-prokurimi si dhe mungesës së trajnimit të duhur për ta.
Ndikimi	Mungesa e njohurive të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit e-prokurimi për menaxhimin e kontratave, ndikon në pamundësitë që menaxhmenti të merr informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
Rekomandimi A5	Ministri duhet të siguroj trajnimin e menaxherëve të kontratave në mënyrë që menaxhimi i kontratave të bëhet përmes modulit të e-prokurimit, me qëllim të mbikëqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mungesa e njoftimit paraprak

Gjetja	Sipas nenit 39 të LPP-së, kur një AK ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej 500,000€ e më tepër, AK duhet të përgatisë njoftimin paraprak. Njoftimi paraprak është ndihmesë në transparencë dhe është në të mirë të OE që të përgatiten dhe njoftohen për prokurimet e mundshme që do t'i zhvilloj AK. Po ashtu, kjo i mundëson AK-ve të zbatojnë afatet e shkurtuara pa pasur nevojë për aprovim të procedurave të përshpejtuara.

MASHTI kishte planifikuar dy kontrata të mëdha si “Ndërtimi i Objektit të Fakultetit të Mjekësisë në Kampusin Universitar të Gjakovës” në vlerë 3,470,074€ dhe “Ndërtimi i shkollës fillore Lidhja e Prizrenit në Deçan” në vlerë 1,522,583€ dhe për të njëjtat nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e volumit të madh të punëve, që ka ndikuar në mos përgatitjen dhe publikimin e njoftimit paraprak për këto kontrata.

Ndikimi Mungesa e njoftimit paraprak nuk përkon me rregullat e prokurimit publik dhe njëkohësisht e ulë edhe transparencën për OE që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme. Po ashtu, kjo ndikon edhe në kufizimin e Ministrisë që të aplikojë afatet e shkurtuara të ofertimit pa pasur nevojë për aprovim.

Rekomandimi A6 Ministrja duhet të siguroj që të gjitha procedurat e prokurimit publik, për kontratat me vlerë të parashikuar të kontratës mbi 500,000€ të përgatisin dhe publikojnë njoftimin paraprak, për të siguruar transparencë për OE dhe mundësinë e AK-ve të zbatojnë afatet e shkurtuara pa pasur nevojë për aprovim të procedurave të përshpejtuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Vonesa në realizimin e projekteve në mungesë të planit ekzekutiv

Gjetja Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik në nenin 10, pikën (b) specifikon se Njësia e kërkesës, e cila është inicues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, përveç tjerash ka përgjegjësi të përgatitë/propozon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike, termat e referencës dhe paramasën dhe parallogarinë. Po ashtu, sipas kushteve të veçanta të kontratës parashihet afati i përfundimit të punimeve.

Gjatë auditimit, kemi vërejtur që MASHTI-i për kontratën "Ndërtimi i objektit të çerdhes në Koretin, Kamenicë" e cila ishte nënshkruar në vitin 2022, nuk kishte arritur të përfundonte punimet deri në vitin 2024 siç ishte përcaktuar në kontratë. Tutje, me datën 26.11.2024 kishte nënshkruar një aneks kontratë duke ndryshuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më 30.09.2025.

Arsyeja ishte se kompania nuk kishte arritur që t'i përmbahet planit dinamik për shkak të mungesës së planit ekzekutiv dhe para masës duke krijuar nevojën për zgjatjen e afatit të përmbushjes së kontratës edhe për një (1) vit si dhe duke shkaktuar vonesa në finalizim të projektit.

Ndikimi Mungesa e planit ekzekutiv ndikon drejtpërdrejt në realizimin e projekteve, duke shkaktuar shpenzime të paparashikuara, vonesa dhe nevojën për aneks-kontrata. Si rezultat, Ministria rrezikon të mos përmbushë objektivat dhe të dështojë në zbatimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt kapital të hartohet dhe zbatohet plani ekzekutiv përpara nisjes së zbatimit, me qëllim të shmangies së nevojës për aneks kontrata dhe punë shtesë, si dhe për të garantuar realizimin e projekteve sipas buxhetit të planifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A8 - Shkëputja e kontratave për projekte kapitale

Gjetja

Sipas nenit 81 të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sipas 61.6, 61.19 dhe 61.20 menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike kornizë ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Gjatë vitit 2024, Ministria iu kishte shkëputur operatorëve ekonomik katër (4) kontrata të projekteve kapital, të cilët nuk kishin arritur të kryenin punimet sipas planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Këto kontrata ishin:

- "Ndërtimi i shkollës fillore dhe të mesme të ulët Fan Noli në Kamenicë"- kontrata ishte nënshkruar më 20.02.2023 për 36 muaj, në vlerë 1,697,453€.
- "Ndërtimi i objekteve për institucionet e nivelit parashkollor në Istog"- kontrata ishte nënshkruar më 11.06.2019, për 36 muaj, në vlerë 669,639€.
- "Ndërtimi i çerdhes në lagjen Arbëria, Klinë"- kontrata e nënshkruar më 20.06.2019 për 36 muaj, në vlerë 560,330€.
- "Ndërtimi i SHM në Ferizaj", kontrata e nënshkruar më 03.11.2020 për 36 muaj, në vlerë 767,153€.

Në tri kontratat e para të shkëputura nga MASHTI, OE-të nuk iu ishin përmbajtur planit dinamik dhe njëanshëm kishin ndërprerë punimet. Për këtë arsye, menaxheri i kontratës kishte propozuar dhe ishte vendosur që t'ju shkëputet kontrata. Ndërsa, tek kontrata e fundit shkëputja ishte bërë për shkak të mungesës së lejes ndërtimore.

Shkëputja e kontratave ka ndodhur si rezultat i mos realizimit të projekteve në kohë, dinamikës së ulët gjatë kryerjes së punimeve dhe në një rast kërkesës së OE për shkëputje të kontratës në mënyrë miqësore.

Ndikimi

Shkëputja e kontratave për projektet kapitale ndikon në vonesat e realizimit të projekteve kapitale, në humbje financiare, në realizim jo të mirë të buxhetit për investime kapitale si dhe të dështoj në arritjen e objektivave të saj.

Rekomandimi A8

Ministri duhet të siguroj mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve për të siguruar përmbushjen e afateve, detyrimeve kontraktuale dhe realizimin e projekteve brenda dinamikës së planifikuar. Ndërsa për avancet e hapura të sigurojë që OE i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Avancet e hapura për projektet kapitale

Gjetja

Rregullorja MF-Nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar nga OB në nenin 20 thekson raportimin avanceve të paarsyetuara. Ligji Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 13-pagesat e paradhënies, pika 5 thekson se avancet që kanë të bëjnë me projektet dhe aktivitetet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë lejohen të mbesin të hapura edhe për vitet pasuese për ato projekte për të cilat liferimi i pajisjeve nuk mund të bëhet brenda një vitit të rregullt fiskal.

Në PFV-të e vitit 2024, te neni 20, MASHTI kishte shpalosur tetë (8) projekte kapitale të pa përfunduara, për të cilat kishin mbetur avance të hapura apo paradhënie në vlerë 424,073€. Këto projekte ishin për ndërtimin e objekteve arsimore për çerdhe dhe shkolla dhe nuk kishin të bënin për projektet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e për të cilat lejohet të mbesin avancet e hapura.

Avancet apo paradhëniet për këto projekte kishin mbetur të hapura ndër vite (2019-2022) dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret që OE-të të arsyetojnë mjetet e marra avanc me realizimin e punëve, edhe përkundër rekomandimit tonë nga viti i kaluar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i menaxhimit dhe kontrolleve jo efektive nga ana e Ministrisë për mbylljen e avanceve në kohën e duhur.

Ndikimi

Vonesat e gjata në realizimin e projekteve kapitale dhe mos mbyllja e avanceve në kohën e duhur ndikojnë që mjetet e avancit të qëndrojnë te operatorët kontraktual duke mos u arritur objektivat.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të sigurohet që avancet për projekte kapitale mbyllen brenda vitit fiskal siç parashihet me rregulla ligjore dhe të monitorohet procesi i avanceve të dhëna për projektet e caktuara. Po ashtu, të specifikohet qartë arsyetimi i tyre për punët e përfunduara që mbulojnë avancet deri në përfundim të vitit fiskal, në mënyrë që të njëjtat mos të mbesin të hapura për vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 159,159,672€, pasurive jokapitale është 3,102,049€, si dhe e stoqeve 1,021,842€.

Çështja B5 - Mos bartja e pronësisë së shkollave të ndërtuara te komunat përkatëse

Gjetja	Sipas nenit 13, pikës 1 dhe 2 të rregulloresMF- Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim. Edhe gjatë vitit 2024, shkollat dhe objektet arsimore të cilat ishin përfunduar nuk ishte bartur pronësia tek komunat përkatëse, edhe pse këto objekte i plotësonin kriteret për zhvillimin e procedurave për dorëzim dhe regjistrimin e tyre si objekte në përdorim. Megjithatë, bartja e pronësisë nuk kishte ndodhur dhe ato mbaheshin ende në regjistrat e MASHTI-it si investime në vijim. Kjo vonesë e bartjes së pronësisë së pasurive nga MASHTI tek komunat përkatëse është një dukuri që ka vazhduar për vite me radhë. Edhe pse procesi i bartjes ishte nisur gjatë vitit 2023, gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë dëshmi që ndonjë shkollë ose objekt është regjistruar tek komunat përkatëse. Sipas tyre, mungesa e burimeve njerëzore ka qenë shkaku që ka ndikuar në këtë proces.
Ndikimi	Mos bartja e pronësisë së plotë të objekteve arsimore ka efekt negativ në menaxhimin e tyre nga organizata që në realitet e ka kontrollin mbi to.
Rekomandimi B5	Ministri duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje të pronësisë te Komunat përkatëse. Po ashtu, në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A9 - Mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare

Gjetja

Sipas rregullores MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 24, pika 1, pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. Ndërsa, sipas nenit 18, inventarizimi i pasurisë jo financiare, pika 3, organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku një herë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare.

Gjatë auditimit është konstatuar se:

- Autoriteti i Kombëtar i Kualifikimeve, si njësi vartëse (program) i MASHTI-it nuk kishte arritur ta gjeneronte raportin e pasurisë jo financiare nga sistemi e-pasuria, duke mos raportuar për gjendjen e pasurisë së saj.
- Nga raportet e të gjitha njësive vartëse dhe raportimit në PFV kemi mos përputhje të pasurive jofinanciare për 5,372€.
- Në anën tjetër, Universiteti i Gjilanit kishte formuar komisionin për inventarizim të pasurisë jo financiare, por nuk kishte arritur të përfundonte dhe të raportonte për gjendjen reale të pasurisë. Ndërsa, Kolegji Publik IBCM dhe Autoriteti i Kombëtar i Kualifikimeve nuk kishin formuar komisionin për inventarizim, e që rrjedhimisht nuk kanë përpiluar raportin e inventarizimit, duke krijuar pasiguri lidhur me gjendjen dhe vlerën reale të pasurisë jo financiare.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos përfundimit të inventarizimit, kujdesit jo të mirë dhe mos koordinimit gjatë raportimit të pasurive nga personeli përgjegjës i njësive vartëse (programeve).

Ndikimi

Raportimi jo i plotë dhe i saktë i gjendjes së pasurive të prezantuara në PFV, si rezultat i mos përfshirjes së pasurive nga të gjitha njësitë vartëse në kuadër të MASHTI-it, ka ndikuar në nënvlerësim të pasurive. Po ashtu, mos përfundimi i procesit të inventarizimit nuk mund të konfirmoj nëse pasuritë jo financiare janë regjistruar dhe mbahen sipas kërkesave ligjore në regjistrat e pasurisë.

Rekomandimi A9

Ministri duhet të zbatoj një proces të rregullt dhe të dokumentuar të inventarizimit të pasurisë jo financiare, koordinim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet të gjitha njësive vartëse (programeve) gjatë raportimit për PFV, duke garantuar që ndryshimet e konstatuara të reflektojnë saktë në gjendjen reale të pasurive jokapitale, dhe se vlera e tyre e paraqitur në PFV është e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funksioni i auditimit të brendshëm

Çështja A10 - Komiteti i Auditimit jo funksional

Gjetja	Neni 6 i Udhëzimit Administrativ të MF-Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit (KA) saktëson që KA emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitë udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik. Po ashtu, neni 8 i këtij udhëzimi përcakton që takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i KA. Në takime diskutohen çështjet siç janë përcaktuar me këtë udhëzim dhe mbahen procesverbale. Komiteti i Auditimit (KA) gjatë vitit 2024 nuk kishte numrin e mjaftueshëm të anëtarëve të tij, pasi një anëtar i cili ishte pjesë e stafit të brendshëm të subjektit të sektorit publik është transferuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) përmes një marrëveshjeje me MASHTI-n. Si rezultat, përbërja e Komitetit të Auditimit ka qenë e përbërë vetëm nga anëtarë të jashtëm deri në nëntor të vitit 2024. Gjithashtu, pas dorëheqjes së një anëtari tjetër në nëntor, komiteti ka mbetur jo-funksional. Gjatë vitit 2024, KA ka mbajtur vetëm tri (3) takime, duke u shqyrtuar tre (3) nga shtatë (7) raportet e NJAB-së. Po ashtu, kryesuesi i KA nuk ka nënshkruar planin vjetor të auditimit të brendshëm. Kjo situatë është rezultat i mungesës së veprimeve të ndërmarra nga ministria për plotësimin me anëtarë të ri komitetin aktual ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore.
Ndikimi	Mungesa e K.A mund të çojë në një mbikëqyrje të pamjaftueshme të aktiviteteve financiare dhe operative të ministrisë, duke e bërë më të vështirë sigurimin e një niveli të lartë të transparencës dhe llogaridhënies. Po ashtu, mungesa e tij mund të ndikojë negativisht në funksionimin e procesit të auditimit të brendshëm.
Rekomandimi A10	Ministri duhet të siguroj që janë ndërmarrë veprimet e duhura që Komiteti i Auditimit të Brendshëm të jetë i plotë dhe funksional, si dhe përbërja e tij të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NJAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[6]	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**100,120,951**	**101,716,383**	**82,149,554**	**68,013,651**	**69,875,116**
Grante Qeveritare - Buxheti	97,751,226	96,953,909	79,743,417	65,920,068	68,084,878
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,449,527	1,130,059	968,848	526,369
Të hyrat vetanake	2,369,725	2,369,725	896,081	625,955	522,320
Donacionet vendore	0	25,821	0	7,220	64,595
Donacionet e jashtme	0	917,401	379,997	491,561	676,955

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,595,432€. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë Nr. 23/2016 të datës 18.08.2024 për ndarje buxhetore të zbatimit të masës 4.2 mbështetje e arsimit, për pakon e ringjalljes ekonomike të subvencionimit të teksteve dhe materialeve shkollore.

Në vitin 2024 MASHTI ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 82,149,554€, me një zvogëlim prej 6% krahasuar me vitin 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**100,120,951**	**101,716,383**	**82,149,554**	**68,013,651**	**69,875,116**
Pagat dhe mëditjet	23,448,078	22,755,113	22,596,897	21,293,577	20,851,630
Mallrat dhe shërbimet	23,250,000	21,020,441	12,901,360	10,828,658	28,161,093
Komunalitë	1,640,459	1,838,462	1,127,131	1,160,090	1,088,348
Subvencionet dhe transferet	8,770,360	29,689,800	28,917,676	18,945,381	6,211,841
Investimet Kapitale	43,012,054	26,412,567	16,606,490	15,785,945	13,562,204

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 692,965€. Ky zvogëlim ishte me vendime të Qeverisë për tërheqjen e mjeteve të kursyera, të pa shpenzuara nga kjo kategori. Shpenzimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 99%;

• Buxheti për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 2,229,559€ me vendime të Qeverisë, për transfer të mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për subvencionimin e teksteve dhe materialeve shkollore. Shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ishte 61%;

• Buxheti final për komunalitë ishte rritur për 198,003€. Shpenzimi nga buxheti për këtë kategori ishte 61%;

• Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere ishte rritur për vlerën 20,919,440€, nga i cili ishin shpenzuar 97%. Rritja e buxhetit në këtë kategori kishte të bënte me subvencionin për blerjen e librave shkollor dhe pajisjeve të tjera shkollore. Nga kjo kategori, po ashtu ishin subvencionuar edhe bursat e studentëve dhe OJQ-të; dhe

• Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 16,559,487€, si rezultat i mos shpenzimit të fondeve. Shpenzimet krahasuar me buxhetin final ishin 63%. Realizimi i buxhetit në këtë nivel ishte si rezultat i menaxhimit jo të duhur të kontratave dhe vonesave në përmbushjen e kontratave gjatë realizimit të projekteve të planifikuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2024 ishin në vlerë 2,729,550€. Ato kanë të bëjnë me participimet, tarifat për akreditim, taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	**2,975,807**	**2,975,807**	**2,729,550**	**2,364,692**	**2,736,910**
Të hyrat jo tatimore	2,975,807	2,975,807	2,707,017	2,352,586	2,699,268
Të hyrat tjera	0	0	22,533	12,107	37,642

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të MASHTI-t ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.
Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime ishin zbatuar, një (1) nuk ishte i aplikueshëm më dhe pesë (5) ende nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë.
Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja, duhet të siguroj një koordinim dhe komunikim të duhur në mes zyreve ligjore të të gjitha njësive vartëse dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen saktë.	Regjistri i detyrimeve kontigjente edhe këtë vit kishte mangësi.	Nuk ka filluar zbatimi

2.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e plotë të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Edhe gjatë vitit 2024 kemi hasur në raste të njëjta, mirëpo vlera e tyre nuk ka ndikim në opinionin e pajtueshmërisë. Gjetja me rekomandim te DD eshte bashkuar me gjetjen lidhur me "Vonesa ne liferimin e mallrave"	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të sigurojë një monitorim efektiv përmes menaxherit të prokurimit se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Po ashtu, vlerësimet e ofertave duhet që të realizohen në përputhje të plotë me kriteret për kapacitetet teknike dhe profesionale të kërkuara në dosjen e tenderit.	Gjatë testimit është vërejtur që gjatë procesit të procedurave të prokurimit janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj përmes menaxherëve të kontratave se pagesat realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e furnizimeve të kontraktuara. Po ashtu, për shkollat tjera ku janë kryer furnizimet sipas këtyre kontratave duhet të realizohen vizita nga Ministria (menaxheri i kontratës) për të siguruar që janë kryer të gjitha furnizimet sipas kontratës.	Në ekzaminimin e dy shkollave në regjionin e Lipjanit, nuk kemi hasur ne mungesë të pajisjeve për furnizimet e të njëjtës natyrë.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të ushtrojë kontrolle efektive në Institutin Albanologjik me qëllim që të gjitha shërbimet kontraktuale të zhvillohen përmes procedurave të prokurimit dhe të jenë transparente.	Gjatë testimit tonë nuk kemi hasur në mostra të cilat janë paguar pa procedura të prokurimit.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Pavarësisht kërkesave nga MASHTI për ndarjen e buxhetit në kategorinë adekuate vërehet se kjo nuk kishte ndodhur nga Kuvendi i Kosovës. Edhe gjatë vitit 2024 kemi hasur në raste të keq klasifikimit.	Nuk ka filluar zbatimi

7.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurohet që avancet për projekte kapitale mbyllen brenda vitit fiskal siç parashihet me rregulla ligjore dhe të monitorohet procesi i avanceve të dhëna për projektet e caktuara. Po ashtu, të specifikohet qartë arsyetimi i tyre për punët e përfunduara që mbulojnë avancet deri në përfundim të vitit fiskal, në mënyrë që të njëjtat mos të mbesin të hapura për vitet në vijim.	Nuk janë ndërmarrë masa gjatë vitit 2024, mirëpo do te verifikohet gjate vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Pasuritë	Ministrja duhet të ndërmerr veprime konkrete që të siguroj regjistrimin e pasurive dhe që të gjitha pasuritë të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e Komunave. Po ashtu, pasuritë e gatshme (paisjet e ndryshme) që blihen për shkolla përkatëse të regjistrohen direkt në regjistrat e shkollave-komunave.	Edhe gjatë vitit 2024 kemi hasur në pasuri të cilat nuk janë bartur tek komunat përkatëse, po ashtu blerje të vitit të cilat nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Pasuritë	Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje te Komunat përkatëse. Po ashtu, të bëhen procedurat formale të bartjes dhe në bashkëpunim me Thesarin, regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunave.	Nuk ka filluar zbatimi.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit

Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit

Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit

Albana Kadriu, Anëtare e ekipit

Besa Morina, Anëtare e ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Nënvlerësimi i pasurive kapitale	Nuk pajtohemi per arsye se: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka përgatitur dhe dorëzuar Memorandumet e Mirëkuptimit (MM) për komunat përkatëse që janë furnizuar me paisje të ndryshme (përfshirë paisje laboratorike, mirëmbajtjeje dhe sanitare). Megjithatë, për shkak të përfundimit të vitit fiskal 2024 dhe afatit shumë të shkurtër për realizimin e procedurave të brendshme, nuk ka qenë e mundur regjistrimi në kohë i këtyre pasurive në modulin e Pasurisë (SIMFK). Në fillim të vitit 2025, komunat kanë filluar të dorëzojnë MM-të e nënshkruara nga kryetarët e tyre, ndërkohë që MASHTI ka qenë dhe mbetet në komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët përkatës komunalë për të siguruar regjistrimin e pasurive në regjistrat komunalë të pasurive. Deshmite per kete qeshtje i gjeni te bashkangjitur.	E gjetura qëndron, për faktin se edhe MASHTI në paragrafin e dytë te komenti ka konfirmuar që për shkak të përfundimit të vitit fiskal 2024 dhe afatit shumë të shkurtër për realizimin e procedurave të brendshme, nuk ka qenë e mundur regjistrimi në kohë i këtyre pasurive në modulin e Pasurisë (SIMFK). Përderisa Memorandumet e Mirëkuptimit nuk janë finalizuar dhe MASHTI nuk i posedon, e njejta është e obliguar që pasuritë e blera t'i mbajë në regjistrat e saj deri në bartjen e tyre, sipas rregullës financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore. Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Nuk pajtohemi për arsye se: MASHTI ne menyre te vazhdueshme ka kerkuar ne Ministrine e Financave rishikimin e ndarjeve buxhetore dhe kategorizimit sipas rekomandimeve te ZKA. Megjithate, kjo kerkese nuk eshte reflektuar ne ndarjet buxhetore perfundimtare te miratuara permes Ligjit për Buxhetin dhe Qarkoreve përkatëse buxhetore. Nje pako e pajisjeve qe furnizohet ne nje shkolle kalon vleren mbi 1000 euro dhe projektet ne teresi jane me vlera te	E gjetura qëndron, për faktin se në raport ne kemi theksuar edhe përpjekjet e MASHTI-it që disa projekte të financohen/buxhetohen te kategoria mallra dhe shërbime, mirëpo fakti që kjo nuk ka ndodhur dhe shpenzimet (keq klasifikimet) janë pjesë e PFV-ve të MASHTI-it, sipas standardeve të auditimit duhet të paraqiten në Raportin e auditim-it të OB-së ku ka ndodhur shpenzimi. Po ashtu, kjo çështje do të adresohet edhe në Raportin Vjetor të

	medha, andaj Ligji i Buxhetit I kategorizon ne kategorine “investime kapitale”. Në praktikë, kur gjatë procedurës së prokurimit vlera për njësi ka rezultuar nën pragun prej 1,000.00 €, si rezultat i ofertave fituese, zhvendosja e mjeteve buxhetore në kategorinë “Mallra dhe Shërbime” nuk ka qenë e mundur. Kjo për shkak të kategorizimit paraprak të mjeteve si “Investime Kapitale” dhe kufizimeve buxhetore sipas Qarkoreve të MFPT-së. Shembull konkret është furnizimi me pajisje IT për Universitetin e Mitrovicës, i kontraktuar si investim kapital dhe i pamundur për rikategorizim. Universiteti i Gjakovës, në vitin 2024 ka realizuar pagesën për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative për zyrën e TI-së, sipas specifikimeve të kërkuara dhe kontratës së nënshkruar me grupin e operatorëve ekonomikë. Pagesa në vlerën prej: 1,250 € furnizim me kompjuter ka kaluar pragun e përcaktuar prej 1,000 € dhe si e tillë është kategorizuar si investim kapital. Cka nenkupton se kjo e gjetur nuk qendron sepse eshte kategorizuar drejte. Ndërkohë, Qendra e Studentëve, ka realizuar pagesa për modulet e reja të aplikimit online për banim dhe ushqim në konviktet studentore, të cilat janë zhvilluar si shtesa të sistemit ekzistues dhe kanë përmirësuar funksionalitetin e tij. Këto janë kategorizuar si shpenzime të kategorisë “Mallra dhe Shërbime”, me bazë ligjore në nenin 7, pika 2 te UA MF 04/2019 dhe kodin ekomomik perkates 13471 në përputhje me kërkesat e Drejtorisë së Strehimit dhe Menzës. MASHTI ka kryer pagesat në mënyrë të përgjegjshme, duke shmangur implikime financiare dhe përmbarimore, në funksion të respektimit të kontratave publike dhe urdhrave të formës së prerë. Ndërsa në rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe urdhërave përmbarimor, Thesari kishte realizuar pagesat në	Buxhetit të Qeverisë. Në Universitetin e Gjakovës, vlera e pagesës ishte 2,980€, nga e cila 1,250€ i takon investimeve kapitale, ndërsa pjesa e pagesës prej 1,730€ kategorizoheshin si mallra dhe shërbime, ose pajisje nën 1,000€. Pika 2 e UA MF Nr 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale ka të bëjë me përsëritjen e aktivitetit/ procesit të projektit ose korrigjim e jo zhvillim të moduleve të reja si në rastin tonë. Ndërsa lidhur me pagesat për modulet e reja të aplikimit online për banim dhe ushqim në konviktet studentore, shpenzimi në fjalë duhet të trajtohet sipas pikës 1 të nenit 7. Shpenzimet kryesore lidhur me asetin ekzistues, pasi që pika 1.1 e këtij neni citon, që “Do të ngrit kapacitetin e një aseti“. Po, ashtu, vlera indikativë e kontratës për projektin në fjalë arrinë vlerën 78,949.06€, shpenzim ky i rëndësishëm dhe domethënës për projektin aktual duke shtuar module te reja dhe duke e avancuar sistemin në fjale. Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.

	kategoritë ekonomike ku kishte mjete në dispozicion pavarësisht faktit që të njejtat nuk i përkisnin kategorisë ekonomike adekuate, siç ishte rasti i realizimit të pagesave të shujtave që përbënin vlerën në total: 221,133.00 euro. Deshmite per kete qeshtje i gjeni te bashkangjitur.	

Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre	Nuk pajtohemi me te gjeturen ne draft raportin e auditimit sa i perket 19 pozitave me UD ne administraten qendrore MASHTI. Gjatë vitit 2024, në kuadër të administratës qendrore, MASHTI, pas hyrjes në fuqi të Rregullores (ZKM)-Nr.09/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, ka finalizuar procesin e riorganizimit dhe ristrukturimit të ministrisë në pajtim me legjislacionin për organizimin e administratës shtetërore. Në pajtim me Vendimet e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, të gjithë nëpunësit janë sistemuar në pozitat përkatëse, të krijuara pas hyrjes në fuqi të rregullores. Duke marr parasysh finalizimin e procesit të ristrukturimit dhe sistematizimit, i cili ka rezultuar me krijimin e pozitave te lira te nivelit drejtues, atehere në pajtim me dispozitat e nenit 35 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, per te gjitha pozitat e lira jane caktuar ushtruesit e detyrës për periudhë 6 mujore. Njëkohësisht, pas miratimit të përshkrimeve të punës nga ana e DMZP-së, Ministria ka filluar me shpalljen e procedurave të rekrutimit per te gjitha pozitat e lira ne kuader te administrates qendrore, qe nga muaji korrik 2024. Deri më tani, 16 prej tyre janë përmbyllur me sukses, ndërsa të tjerat janë në proces të rekrutimit. Si perfundim, asnje ushtrues i detyres ne administraten qendrore te MASHTI nuk ka vendim qe ka tejkaluar afatin mbi 6 muaj, cka do te thote qe jane në përputhje të plotë me dispozitat ligjore përkatëse. Deshmite per kete qeshtje i gjeni te bashkangjitur.	Ligji për zyrtarët publik përcakton se asnjë pozitë nuk mund të caktohet ushtrues detyre më gjatë se gjashtë 6 muaj dhe kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për 6 muaj të tjerë. Ndryshimi i vendimit të UD, pas hyrjes në fuqi të Rregullorës (ZKM)-Nr.09/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, për personat që kanë qenë UD që nga viti 2018 e tutje nuk nënkupton që MASHTI nuk e ka tejkaluar afatin e lejuar ligjor (6 + 6 muaj) prandaj gjetja nuk ndryshohet dhe rekomandimi mbetet i njejtë. Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.
Financimi i Librave Shkollor për klasat 1-9	Nuk pajtohemi për arsye se: Në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/87, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) ka filluar zbatimin e	E gjetura qëndron, për faktin se Financimi i Librave Shkollor për klasat 1-9, ju është mundësuar të gjithë qytetarëve prindër apo kujdestarë ligjor të fëmijëve nga mosha 5-15 vjeç, pa ndonjë tjetër

	skemës së shpërndarjes së teksteve shkollore përmes modelit të subvencionimit financiar të drejtpërdrejtë tek prinderit/kujdestari ligjor. Ky ndryshim është realizuar përmes platformës digjitale shtetërore e-Kosova, duke kaluar nga furnizimi fizik në një model më të qëndrueshëm dhe efikas financiarisht. Platforma e-Kosova administrohet nga Agjencia për Shoqëri të Informuar (ASHI), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-145. Si rrjedhojë, MAShTI nuk ka pasur kompetencë për të vendosur kufizime teknike në funksionalitetet e kësaj platforme. Megjithatë, për të garantuar integritetin dhe transparencën e skemës, MAShTI ka ndërmarrë një sërë masash: 1. Deklarimi nën përgjegjësi ligjore nga aplikuesit Gjatë procesit të aplikimit, është paraparë që çdo aplikues të deklarojë, nën përgjegjësi ligjore, se i plotëson kushtet për përfitim të subvencionit. Ky mekanizëm është vendosur për të forcuar përgjegjësinë individuale dhe për të zvogëluar rrezikun e deklarimeve të pasakta. 2. Formimi i Grupit Punues për Verifikimin e Aplikimeve Me Vendimin Nr. 01B-162, MAShTI ka formuar një grup punues për verifikimin e aplikimeve, menjëherë pas hapjes së thirrjes publike për aplikim. Qëllimi i këtij grupi ishte të sigurohej se mjetet publike shpërndahen vetëm tek përfituesit që përmbushin kriteret e përcaktuara 3. Procesi I verifikimit dhe ndërprerja e përkohshme dhe harmonizimi me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave Gjatë fazës së verifikimit, me Vendimin Nr. 215/2024, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) kërkoi pezullimin e përkohshëm të këtij procesi, me qëllim që përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale nga ana e MAShTI të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-132 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. MAShTI i është përmbajtur këtij vendimi dhe	përjashtim. Bazuar në analizat dhe testet tona, ne kemi vërejtur që kemi përfitues fëmijë që kanë moshën 5 vjeç dhe nuk kanë filluar shkollimin, si dhe 15 vjeç dhe kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ulët si dhe tani janë duke ndjekur shkollimin e mesëm të lartë. Këtyre rasteve, platforma ju lejon marrjen e subvencionit edhe pse nuk ju takonte. Gjithashtu, në këtë grup të qytetarëve ka fëmijë që janë larguar nga Kosova dhe nuk janë banorë rezident. Analiza e bërë nga ne ishte vetëm sa për të konfirmuar që platforma i lejon qasje përfituesve të pa kualifikuar, jo vetëm në 22 shkollat e testuara por në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës. Theksojmë që është detyrë e MASHTI-it t'i identifikoj dhe të saktësoj të dhënat e të gjithë përfituesve për të siguruar pasqyrim sa me të drejtë të realitetit.

	ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për harmonizim me legjislacionin përkatës, duke vazhduar më pas me procesin e verifikimit. 4. Procedura për rikthimin e fondeve në rastet e përfitimeve të padrejta Si rezultat i procesit të verifikimit, janë identifikuar raste të përfitimeve të pabazuara në kritere ligjore. MAShTI ka iniciuar procedurat për rikthimin e mjeteve në buxhetin e shtetit, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Udhëzimet përkatëse të Thesarit për kthimin e mjeteve në Llogarinë e Vetme të Thesarit (LIVTH). Pavarësisht ekzistencës së hapësirës për përmirësime teknike në të ardhmen, MAShTI konsideron se hapat e ndërmarrë deri më tani reflektojnë një qasje të përgjegjshme dhe të kontrolluar në administrimin e fondeve publike dhe në mbrojtjen e integritetit të skemës së subvencionimit. Dokumentacioni mbështetës i veprimeve të ndërmarra nga MAShTI është bashkangjitur kësaj përgjigjeje për shqyrtim të mëtejmë nga zyra e auditimit.	

Avancet e hapura për projektet kapitale	Nuk pajtohemi per arsye se: Rregullorja MF-Nr. 01/2017 neni 20 ka te beje me parate e imeta, udhëtime zyrtare dhe paratë e dhëna në dorë për ambasadat, e jo per projektet kapitale. Neni 13 ne Ligjin e buxhetit 08/L-260 neni 13 pika 5, ka te beje per projektet qe lidhen me mbrojtjten dhe sigurine, e nuk ka te bëjë per projekte kapitale. Sa i perket projekteve kapitale, pagesa e avancit është veprim i paraparë sipas ligit 08/L-260 neni 13 pika 2 dhe 4, e cila realizohet në përputhje me dispozitat e nenit 26 pika 1; 2 dhe 3 ne kontratat përkatëse, ku theksohet se avancet mbulohen me garanci bankare; avancet realizohen për të paguar pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme në veçanti për kontrata të puneve; dhe zbritja e avancit bëhet në mënyrë proporcionale përmes faturave per punë të realizuara gjatë periudhës së zbatimit të kontratës. Andaj, avanci regjistrohet si shpenzim buxhetor në vitin fiskal në të cilin është realizuar pagesa, dhe nuk ka dispozitë ligjore që kërkon që i gjithë avanci per projekte kapitale shumevjecare të zbritet apo mbyllet brenda po atij viti fiskal. Gjithashtu kjo mund te vertetohet edhe permes raportit te auditimit te MKRS per vitin 2022, ku ne Çështjen A4 auditori rekomandon qe të aplikohet zbritja proporcionale e pagesës së avancit për investime kapitale sipas nenit 26.3 ne kontrate. Kjo do te thote se, me aplikimin e nenit 26.3 te kontrates nuk eshte e mundur te zbritet avanci brenda viti fiskal per projektet shume vjeqare. Deshmite per kete qeshtje i gjeni te bashkangjitur.	E gjetura qëndron, çështja është e përsëritur nga viti i kaluar, për të cilën MASHTI është pajtuar vitin e kaluar për të njëjtën çështje, e cila tash po kundërshohet. Avancet apo paradhëniet për këto projekte kishin mbetur të hapura ndër vite (2019-2022) dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret që OE-të të arsyetojnë mjetet e marra avanc me realizimin e punëve, edhe përkundër rekomandimit tonë nga viti i kaluar. Ndërlidhja me raportin e MKRS të vitit 2022, nuk është e ngjashme me rastin e MASHTI-it, pasi këtu nuk kemi zbritje proporcionale, por kemi avanse që janë dhënë nga MASHTI ndërsa punët nuk janë përfunduar, marrë parasysh kohën e avanseve të dhëna (2019-2022). Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.

Vonesa në realizimin e projekteve në mungesë të planit ekzekutiv	Nuk pajtohemi per arsye se: Njësia kërkuese i ka sjellur të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në nenin 10 pika (b) të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurim Publik, dhe të gjitha këto dokumente kanë qenë pjesë përbërse e kontratës. Plani i menaxhimit të kontratës është dokumenti ligjor i cili kerkohet dhe eshte i përfshirë në dosjen për implementin të projektit, ndërsa eshte e paqarte kërkesa e disponueshmërisë së një Plani ekzekutiv, pasi që një dokument i till në aspektin ligjor dhe procedural nuk ekziston.	E gjetura qëndron, pasi që sipas kontratës dhe planit të menaxhimit të kontratrës, validiteti i kontratës ishte nga 28.09.2022 për periudhën dy vjeçare. Mirëpo e njejta nuk ishte finalizuar dhe ishte lidhur ankes kontratë deri më 30.09.2025. Kjo vonesë në finalizim të kontratës ishte për faktin e mungesës së projektit dhe paramasës me rastin e zhvillimit të procedures së prokurimit dhe lidhjes së kontratës. Për më tepër “Udhëzuesi për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore” nga MASHTI thekson rëndësinë e përgatitjes së një projekti të detajuar teknik për çdo ndërtim ose renovim të shkollave. Ky udhëzues shërben si referencë për të gjithë profesionistët e përfshirë në procesin e planifikimit, projektimit dhe ndërtimit të objekteve arsimore.

Shkëputja e kontratave për projekte kapitale	Nuk pajtohemi per arsye se: Në lidhje me gjetjen e auditimit që evidenton ndërprerjen e disa kontratave për projekte kapitale, konsiderojmë se kjo masë nuk duhet të vlerësohet si element negativ i menaxhimit apo zbatimit të projekteve. Ndërprerja e kontratave është veprim i legjitimuar nga vetë kushtet e kontratës, të cilat parashikojnë mundësinë e ndërprerjes së kontrates në rastet kur operatori ekonomik nuk i përmbahet obligimeve të përcaktuara, përfshirë vonesat pa arsye të justifikuara apo mungesën e progresit të punimeve. Në të gjitha rastet e ndërprerjeve, menaxherët përkatës kanë vepruar në përputhje me dispozitat kontraktuale. Si rrjedhojë, ndërprerja e kontratave nuk përfaqëson një mangësi në menaxhimin e projekteve, por përkundrazi, një qasje të përgjegjshme dhe ligjërisht të bazuar për të parandaluar dëme të mëtejshme institucionale dhe buxhetore. Ne te kaluaren pikerisht per mos nderprerje te kontrates, kemi marr rekomandime per mosveprim.	E gjetura qëndron, për faktin se kontratat e ndërprera ishin nga vitet paraprake, respektivisht nga 2019-2023, e të cilat nuk ishin realizuar/menaxhuar sipas kushteve të kontratës. Në tri kontratat e para të shkëputura nga MASHTI, OE-të nuk iu ishin përmbajtur planit dinamik dhe njëanshëm kishin ndërprerë punimet. Për këtë arsye, menaxheri i kontratës kishte propozuar dhe ishte vendosur që t'ju shkëputet kontrata. Ndërsa, tek kontrata e fundit shkëputja ishte bërë për shkak të mungesës së lejes ndërtimore. MASHTI, për avancet e hapura të këtyre kontratave të shkëputura të sigurojë që OE i ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj ministrisë. Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.

Mos bartja e pronësisë së shkollave të ndërtuara te komunat përkatëse	Nuk pajtohemi per arsye se: MASHTI ka përfunduar ndërtimin e disa objekteve arsimore, të cilat janë përfshirë në Memorandumet e Mirëkuptimit (MM) me komunat përkatëse të Republikës së Kosovës. Sipas procedurave të përcaktuara, regjistrimi i këtyre objekteve si pasuri në regjistrat komunalë duhet të kryhet nga komunat, të cilat më pas obligohen të dërgojnë ID-të e pasurive të regjistruara te MASHTI, në mënyrë që këto objekte të mund të shlyhen nga regjistrat kontabël të MASHTI-t. Në Memorandumet e fundvitit 2024 janë përfshirë tri objekte shkollore të përfunduara: • Një në Komunën e Gjilanit dhe • Dy në Komunën e Junikut, me një vlerë totale prej: 1,878,370.02 €. Aktualisht jemi në pritje të konfirmimit zyrtar nga komunat përkatëse për regjistrimin e këtyre objekteve si pasuri në regjistrat e tyre, në mënyrë që të përmbushet procesi formal i bartjes së pronësisë. Sqarim proceduror: Shlyerja e pasurive ose ndërrimi i statusit të tyre nga regjistrat kontabël të MASHTI-t kryhet nga Departamenti i Thesarit në MFPT, në përputhje me: • Rregulloren Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, dhe • Bazuar në kërkesat dhe dokumentacionin e dërguar nga MASHTI, të harmonizuara me informacionet e mbledhura nga zyrtarët përgjegjës të pasurive. Deshmite per kete qeshtje i gjeni te bashkangjitur.	E gjetura qëndron, për faktin se MASHTI vitin e kaluar ishte pajtuar dhe zotuar se do të merr veprime për të adresuar këtë rekomandim. Megjithatë, vonesa e bartjes së pronësisë së pasurive nga MASHTI tek komunat përkatëse është një dukuri që ka vazhduar për vite me radhë. Edhe pse procesi i bartjes ishte nisur gjatë vitit 2023, gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë dëshmi që ndonjë shkollë ose objekt është regjistruar tek komunat përkatëse Bazuar në këtë, bartja e pronësisë nuk kishte ndodhur dhe ato mbaheshin ende në regjistrat e MASHTI-it si investime në vijim. Dokumentet e ofruara nuk dëshmojnë ndryshimin e gjendjes së pasqyruar.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
DATE/PRANUAR/DOBIJENO: 29-05-2025
DATUM/PRIMLJEN/DOSTAVLJEN:
DATE/RECEIVED/SUBMITTED:

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr.i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	820	1

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INOVATION
Nr. Br. No. 01/2047 DALJE Data Datum Date 28.05.2025
Nr. Gaj. Broj Strana 1
Prishtinë Prishtina Prishtina

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija/Ministry of Education, Science, Technology and Inovation

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit**, për vitin 2024;
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, ndërsa komentet dhe dëshmitë i gjeni të bashkangjitur;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Arbëric Nagavci, Ministre në detyrë

Data: 28.05.2025

Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[7] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[8], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Fatura e shpalosur si obligim në PFV për "Furnizime për pastrim" në vlerë 3,441€, deri me 31.12 ishte 96 dite vonesë për pagesë.

[6] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[7] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[8] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.